

**PROGRAMI I PARTISË
SHPRESA DEMOKRATE**



Partia Shpresa Demokrate është parti e djathtë, është partia jonë dhe e juaja, është partia, e cila u hap dyert dhe u jep rastin të punojnë për prosperitetin e kombit shqiptar të gjithë shqiptarëve patriote.

Partia Shpresa Demokrate u hap dyert pa dallim të gjithë intelektualëve nacionalistë, që deri tani kanë qëndruar në heshtje; të rinjve, grave, punëtorëve e fshatarëve, të cilët e duan këtë vend të begatë, të lulëzuar, të përparuar e me dinjitet, përkrah vendeve të tjera të zhvilluara të Botës.

Partia Shpresa Demokrate, duke pasur si qëllim prosperitetin e kombit shqiptar, duke e konsideruar veten si e vetmja shpresë shpëtimi për një komb, u bën thirrje të gjithë bijve të denjë të këtij vendi të bashkohen në të njëjtin front dhe të shtrëngojnë radhët për të punuar e luftuar me mjete vërtet demokratike për një çështje kaq madhore siç është zhvillimi e përparimi politik e ekonomik i vendit dhe vendosja në vend e dinjitetit tonë kombëtar, për ngritjen e funksionimit e shtetit ligjor mbi bazën e parimeve demokratike, për vlerësimin e vullnetit e të personalitetit të çdo shqiptari dhe realizimin e interesave dhe të drejtave të çdo shtetasi.

1. Qëllimi i Partisë Shpresa Demokrate

Partia Shpresa Demokrate është parti e djathtë, e organizuar mbi bazën e parimeve të demokracisë amerikane, nga të rinjtë intelektualë e patriotë shqiptarë, me qëllim ardhjen në pushtet dhe për të marrë përsipër, me përgjegjësi të plotë përpara kombit, misionin e nxjerrjes së tij nga kriza ekonomike, politike dhe morale. Partia Shpresa Demokrate është e vetmja që do të përmbushë interesat e shtetasve kudo dhe kurdoherë. Programi i saj është mishërim i aspiratave më të ngushta, ku dotë gjejë veten më së miri çdo shtetas. Ajo kërkon mbështetjen e të gjithëve dhe u garanton shtetasve përmbushjen e detyrimeve të tyre në aspektin ekonomik e shoqëror.

Partia Shpresa Demokrate merr përsipër hedhjen e themeleve të shëndosha për ndërtimin e funksionimin e shtetit mbi bazën e parimeve të një demokracie të vërtetë e të qëndrueshme, ngritjen e dinjitetit kombëtar dhe rritjen e respektit ndaj vendit tonë në arenën ndërkombëtare, duke e vendosur kombin dhe shtetin tonë në pozita të barabarta politike, ekonomike e morale me shtetet e tjera të Botës së përparuar perëndimore.

2. Partia Shpresa Demokrate garanton bashkimin financiar, tregëtar, arsimor, kulturor të të gjithë shqipëtarëve

a. Partia Shpresa Demokrate nuk do ta reshtë kurrë punën për t'i bërë shqiptarët të ndjehen e të jetojnë si komb unik, ashtu si na ka krijuar vetë natyra, në trojet e stërgjyshërve tanë, më të lashtë se të gjitha kombet e tjera të Ballkanit

3. Partia Shpresa Demokrate garanton një Kosovë të lirë e demokrate, ku do të mbizotërojë liria e fjalës dhe e mendimit të shtetasve kosovarë.

a. Partia Shpresa Demokrate, me politikat e saj, do të synojë krijimin e kuadrit ligjor dhe respektimin e lirive dhe të të drejtave themelore të njeriut, të sanksionuara në aktet ndërkombëtare. Nisur nga koncepti i saj politik, kjo parti siguron të drejta e liritë tilla, si e drejta e jetës, liria personale, e drejta për të kërkuar rivendosjen e një të drejte të shkelur, barazia përpara ligjit, liria e fjalës dhe e shtypit, e organizimit partiak, e tubimit paqësor, e peticionit, e drejta për të zgjedhur e për t'u zgjedhur, e drejta e lëvizjes së lirë brenda vendit dhe jashtë tij.

b. Partia jonë do t'i japë fund, një herë e përgjithmonë, zhvleftësismit dhe denigrimit të institutit të votes së lirë, personale, të fshehtë dhe të barabartë.

Nuk mund të lejohen më nëpërkëmbja dhe përdorimi për interesa personale i votës dhe i vullnetit të zgjedhësve nga një grup antishqiptarësh. Ne garantojmë se vlera e votes do të ngrihet në kufijtë e së shenjtës. Vullneti i zgjedhësit do të jetë

ai që do të përcaktojë çfarë është emirë dhe çfarë jo, kush mund të qeverisë e kush jo.

4. Partia Shpresa Demokrate garanton votuesin.

Personave, që do të kërkojnë të kandidojnë, do t'u bëhet publike dosja personale. Ky është rregulli i demokracisë, që duhet ta respektojmë e ta pranojmë të gjithë.

a. Duke pasur parasysh se sa i rëndësishëm është përfaqësimi i vullnetit të çdo shqiptari për përparimin e kombit, një vëmendje e veçantë do t'u kushtohet organizimit dhe funksionimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, si organi sovran, i cili është shprehje e qartë e realizimit të demokracisë së përfaqësuar. Në ndryshim nga qëndrimet e deritanishme, përfaqësimi i vullnetit të popullit do të realizohet nga individë, të cilët paraqesin integritet të lartë moral, vlera politike, qëndrime atdhetare, aftësi intelektualee profesionale, si dhe përkushtim e ndërgjegje të lartë në përmbushjen e detyrës së përfaqësimit të interesave të zgjedhësve, që përfaqësojnë. Përfaqësuesit e popullit do të zgjidhen si të tillë në bazë të kritereve të shëndosha dhe do të jenë në shërbim të zgjedhësve.

b. Nuk do të lejohet me ligj krijimi i privilegjeve dhe shmangia nga kontrolu i personave me imunitet. Asnjë përfaqësues i popullit nuk mund të jetë i papërgjegjshëm për sjelljen e tij, për qëndrimet, që mban në kryerjen e detyrës, për mënyrën se si paraqet interesate zgjedhësve, që përfaqëson. Privilegjet dhe përfitimet, të cilat ia kanë siguruar vetes

c. Transparenca e figurës së zyrtarëve të lartë të shtetit do të kërkohet e do të bëhet publike që në momentin kur individit do të kërkohet të kandidojë. Personave, që do të kërkohen të kandidojnë për deputet, për postin e Presidentit të Republikës, për kryeministra apo ministra, për poste të barazuara me ministra, për gjyqtarë apokurorë, si dhe personave, që do të kandidojnë për t'u zgjedhurnë organet e pushtetit vendor, do t'u bëhet publike, në median e shkruar dhe atë elektronike, dosja personale. Vetëm kështu dotë mund të kemi një shtet, në të çilin parimet e demokracisë dhe mekanizmi i saj të funksionojnë plotësisht.

5. Partia Shpresa Demokrate garanton që nënshtetasit kosovarë të kenë të drejtë të udhëtojnë kudo, si popujt e tjerëtë Evropës, pa marrë viza ambasdash.

a. Në marrëdhëniet ndërkombëtare do të hartohen politika e dotë përcaktohen qëndrime, që do të kenë për objekt respektimine të drejtave të shqiptarëve në përputhje me të gjitha aktet ndërkombëtare, për t'i prerë rrugën qëndrimeve diskriminuese dhe për t'u kthyer bashkëkombësve tanë dinjitetin, që u takon. Shqiptarët duhet të kenë të gjitha të drejtat, që kanë edhe shtetasite shteteve të tjera të Botës edhe kur janë jashtë kufijve tanë shtetëror.

Një nga synimet e politikës së Partisë Shpresa Demokrate dotë jetë edhe heqja e regjimit të vizave për shqiptarët, që duan të shkojnë në vende të tjera të Botës, si dhe garantimi i

një respekti e trajtimi më të mirë nga ana e zyrtarëve të përfaqësive diplomatike të huaja të akredituara në vendin tonë.

6. Partia Shpresa Demokrate garanton të ketë marrëdhënie miqësie dhe bashkëpunimi të hapur me shtetet fqinje. Asnjë shtet nuk do të lejohet që të ushtrojë interesat e veta në dëm të interesave tona.

a. Një kujdes i veçantë do t'u kushtohet rishikimit e rikonceptimit, nën optikën e interesave kombëtare, të marrëdhënies politike e ekonomike me shtetet fqinje.. Parimi i vendosjes së interesit kombëtar mbi çdo interes tjetër, do të jetë parimi i shenjtë, i cili do të udhëheqë politikën e fqinjësisë së mirë. Nuk do të lejohet ndjekja, nga ana e fqinjve, e politikave dhe e qëndrimeve, që synojnë cënimin e integritetit politik e moral të shqiptarëve. Veprimtaritë, që synojnë dëmtimin e interesave ekonomiketë vendit tonë, do të ndalohen. Do të mbahet qëndrim e do të penalizohen të gjithë personat e veprimtaritë, që kanë si qëllim cënimin e rendit kushtetues të vendit tonë. Veprimtari të tilla, që synojnë shkatërrimin e ekzistencës së kombit tonë, do të jenë objekt i drejtësisë. Këto qëndrime, në ndryshim nga qëndrimete mbajtura nga politikanët e deritanishëm, kurrsesi nuk mund të jenë objekt i traktativave politike.

7. Politika e Partise Shpresa Demokrate, në fushën e marrëdhënies ndërkombëtarë, do të ketë si parime bazë: bashkëpunimin, reciprocitetin, mosndërhyrjen në punët e

brendshme, mbrojtjen e interesave kombëtare, nxitjen e iniciativave paqeruajtëse, pjesëmarrjen në organizime ndërkombëtarë, me qëllim zhvillimet pozitive politike e ekonomike.

PROGRAMI

8. Partia Shpresa Demokrate garanton që të respektojë statuset dhe rregullat e Kombeve të Bashkuara, të cilat sigurojnë lirinë e të gjitha shteteve të Botës.

9. Partia Shpresa Demokrate garanton, sipas rregullave dhe ligjeve kombëtare e ndërkombëtarë, se nuk do të lejohet asnjë ambasador e asnjë diplomat të ndërhyjnë në punët e brendshme të Republikës së Kosovës.

Një nga synimet e politikës së Partisë Shpresa Demokrate është edhe respektimi me rreptësi i normave ndërkombëtarë lidhur me veprimtaritë diplomatike dhe aktivitetin e diplomatëve. Nuk dotë lejohen, si deri më sot, që diplomatët e huaj të ndërhyjnë në veprimtarinë e organeve të Republikës së Kosovës dhe për më tepër, të kryejnë veprimtari në dëm të interesave të kombit, duke implikuar struktura të pushtetit e duke rekrutuar nëpunës. Do të synohet që çështjet e organizimit e të funksionimit të strukturave shtetërore të jenë vetëm çështje të brendshme të shqiptarëve dhe të mos kthehenytë e të kërkohet bekimi i ambasadorëve të huaj për një vendim apo veprim, i cili nuk ka lidhje me marrëdhëniet diplomatike.

10. Partia Shpresa Demokrate garanton të ketë marrëdhënie të mira diplomatike, ekonomike e kulturore me shtetet

evropiane. Asnjë shtet nuk do të lejohet që të ushtrojë ndikimete veta në dëm të interesave tona kombëtare.

Në kuadrin evropian do të synohet ndjekja e një politike miqësie ebashkëpunimi me të gjitha vendet komunitare, me qëllim nxitjen e shkëmbimeve ekonomike, duke krijuar mundësi të lëvizjes së kapitalit, për të bërë të mundur thithjen e investimeve të huaja dhe nxitjen e zhvillimit të aktiviteteve prodhuese të vendit. Në këtë drejtim do të synohet lehtësimi dhe, ku është e mundur, heqja e barrierave fiskale, duke krijuar një klimë ekonomike stimuluese për zhvillimin e bizneseve prodhuese vendase, me mbështetje financiare nga kapitali i huaj.

Do të synohet krijimi i kuadrit ligjor dhe i strukturave të përshtatshme për zhvillimin e të gjitha degëve të ekonomisë, si industria e rëndë dhe e lehtë, bujqësia dhe, në mënyrë të veçantë, turizmi.

11. Partia Shpresa Demokrate garanton një miqësi me Shtetet Bashkuara të Amerikës.

Partia jonë, në mënyrë të veçantë, do të nxisë e do të synojë forcimin e lidhjeve të miqësisë së djeshme e të sotme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si aleate historike të interesave jetikete kombit shqiptar, si shembulli më i mirë i organizimit dhe i funksionimit të demokracisë, si shembulli më i mirë i vendit më të zhvilluar e më të fuqishëm politikisht, ushtarakisht e ekonomikisht. Bashkëpunimi do të shtrihet në fushën ekonomike, duke stimuluar e lehtësuar investimet e kompanive amerikane në sektorët strategjikë të ekonomisë

së vendit: industrinë nxjerrëse përpunuese të mineraleve, industrinë e naftës, industrinë energjetike, telekomunikacionin, aktivitetet ndërtimore, industrinë tekstile, konfeksionet, industrinë ushqimore dhe bujqësinë.

12. Partia Shpresa Demokrate u garanton trajtim e nderim të veçantë të gjithë të rinjve, që janë përleshur e gjakosur me forcat e errëta në demonstratat antikomuniste. Këtyre njerëzve u duhen dhënë vendi dhe privilegjet, që u takojnë, për kontributin edhënë në zhvillimet demokratike në Kosovë. Historia nuk mund dhe nuk duhet t'i harrojë ata.

13. Partia Shpresa Demokrate garanton rivlerësim e shpërblim real.

Rishikimi e ridimensionimi i historisë do të synojë jo vetëm vlerësimin moral të figurave të kombit dhe të shtresës së persekutuar, por edhe dhënien e shpërblimeve reale në të hollatë gjithë atyre që janë internuar, burgosur, apo kanë humbur jetënnëpër burgje. Nën dritën e këtij realiteti do të rishihet kompensimi i drejtë edhe i atyre që kanë qenë të burgosur politikë, duke konvertuar në para vlerën e plotë të letrave me vlerë, të cilat janë dhënë pa kriter e në mënyrë shpërdoruese nga qeveritë e derisotme.

14. Partia Shpresa Demokrate u garanton të rinjve nga familjet e të përndjekurve politikë se do t'u mundësohet e drejta e ndjekjes së arsimit të lartë me financim të plotë nga

shteti. Gjithashtu, falas do të mundësohen të gjithë të rinjtë e të përndjekurve politikë, që dëshirojnë të shkollohen në shkollat perëndimore, për kryerjen e studimeve të larta në fusha të ndryshme të shkencës, të artit e të kulturës.

15. Partia Shpresa Demokrate garanton se besimi fetar duhet të jetë i lirë dhe çdo shqiptar ka të drejtë të besojë në fenë e tij.

Me politikat shtetërore do të synohet garantimi i së drejtës të çdo qytetari për të ushtruar lirisht ritet e besimit fetar, që ai ka zgjedhur.

16. Feja dhe shteti janë dy institucione të ndara dhe të pavarura nga njëri - tjetri.

Lidhur me besimet fetare, Partia Shpresa Demokrate, duke u nisur nga parimi i ndërtimit të një shteti laik, do të implementojë politika, të cilat ruajnë integritetin e strukturave shtetërore nga ndikimi i religjioneve.

17. Partia Shpresa Demokrate u garanton të gjithë atyre, që shërbejnë në qendrat fetare, pagesën e pensioneve dhe të sigurimeve shëndetësore.

18. Partia Shpresa Demokrate garanton se do të respektojë parimin, sipas të cilit prona është e shenjtë.

E drejta e pronësisë, e shkelur dhe e nëpërkëmbur nga qeverisjet komuniste e kriptokomuniste, do të rivendoset duke iu kthyer prona të zotit. Për të realizuar këtë proces do të shërbejë si bazë gjendja faktike e pronësisë para vitit 1946 si dhe do të mbahen parasysh ndryshimet demografike të popullsisë. Në të gjitha rastet, kur do të gjykohet se objektivisht ka pamundësi të plota për t'u kthyer prona, ish-pronari do të kompensohet me objekte të së njëjtës vlerë ose me kundërvleftën e plotë në para.

19. Partia Shpresa Demokrate garanton që pasuria private të jetë e paprekshme nga qeveria.

20. Partia Shpresa Demokrate garanton strehim për të gjithë të pastrehët.

Duke pasur si qëllim kryesor përmirësimin e kushteve të jetesës dhe ngritjen e nivelit të saj drejt niveleve të vendeve të zhvilluara perëndimore, Partia Shpresa Demokrate garanton hartimin dhe zbatimin e politikave të vazhdueshme të strehimit për të gjithëtë pastrehët. Për arritjen e këtij qëllimi, do të projektohen e dotë ndërtohen banesa sipas parametrave bashkëkohorë dhe do të stimulohet sistemi i

kreditimit për blerjen e tyre ose për ristrukturimin e banesave ekzistuese.

21. Partia Shpresa Demokrate garanton furnizimin me ujë e energji për të gjithë shqiptarët.

Në politikat sociale e ekonomike të Partisë do të përfshihen edhe plane strategjike afatgjata e afatshkurtra për garantimin e sistemit energjetik dhe atë të furnizimit të banorëve me ujë,

në mënyrë që kriza e deritanishme të mbetet një kujtim i largët i një të kaluare jo të largët. Do të hartohen politika zhvillimi, nëpërmjet të cilave do të bëhen të mundura ndërtimi i burimeve të reja energjetike dhe ndërtimi i sistemeve të furnizimit me ujë, që energjia elektrike dhe uji të jenë të pranishëm gjatë 24 orëve edhe në familjet, të cilat banojnë në zonat më të largëta të vendit.

22. Partia Shpresa Demokrate garanton sistemin urban.

Në përputhje me parametrat e urbanizimit modern si dhe nevojat e vendit, do të kryhen sistemime urbane dhe do të investohet për ndërtimin e një rrjeti rrugor të përshtatshëm për zhvillimin e vendit dhe për lëvizjen e lirë e të shpejtë të njerëzve e të mallrave. Sistemimet urbane do të synojnë krijimin në qendrat e urbanizuara të mjediseve të përshtatshme për plotësimin e të gjitha nevojave të banorëve, duke pasur parasysh ritmet e zhvillimit ekonomik, teknologjik

e social.

Sistemi i transportit të udhëtarëve e të mallrave do të sistemohet e do të disiplinohet nga pikëpamja ligjore, organizative e administrative, për t'u bërë efektiv dhe për të ofruar një shërbim tëshpejtë, të sigurt, komod e me kosto të ulët.

23. Partia Shpresa Demokrate u garanton punësim të gjithë kosovarëve.

Politikat e punësimit do të trajtohen me përparësi, duke krijuar kuadrin e përshtatshëm ligjor e institucional, në mënyrë që të nxiten hapja e vendeve të reja të punës, rritja e nivelit të pagës dhe njëkohësisht krijimi i kushteve të përshtatshme për punë.

Vëmendje e veçantë në këtë fushë do t'i kushtohet ndërprerjessë fenomenit të shfrytëzimit të punës së papaguar të punonjësve, që punojnë në punë të zezë, të cilëve nuk u paguhet kontributi i sigurimeve shoqërore nga punëdhënësi, duke krijuar kështu një kategori njerëzish, që nuk do të mund të përfitojnë pension dhe, në të njëjtën kohë, duke sjellë çoroditje të skemës së sigurimeve e, për rrjedhim, nivele të ulta pensionesh.

24. Partia Shpresa Demokrate garanton pagat sipas standardeve të Evropës.

Si një nga çështjet më të rëndësishme, politikat e Partisë do të

trajtojnë gjetjen e mundësive dhe ristrukturimin e sistemit të pagave, duke i rritur ato në mënyrë të vazhdueshme, me synimin e rritjes së të ardhurave për frymë të popullsisë e për rrjedhim, rritjen e nivelit të jetesës në përgjithësi. Këto politika do të kenë siferencë nivelet e pagave dhe të ardhurat për frymë të vendeve të zhvilluara perëndimore.

25. Partia Shpresa Demokrate u garanton shërbimet shëndetësore falas të gjithë shtetasve.

Ristrukturimi i sistemit të shërbimeve shëndetësore do të jetë një nga përparësitë e politikave të Partisë Shpresa Demokrate, me qëllim që t'u ofrohet shërbimi falas të gjithë shtetasve edhe në skajet më të largëta të vendit. Çështjet kryesore të këtij ristrukturimi do të jenë: ndërtimi i objekteve shëndetësore në çdo qendër të banuar, ndërtimi i, të paktën, një spitali në çdo qytet dhe pajisja e tyre me mjete të teknologjisë bashkëkohore; rritja e pagës së mjekëve dhe e personelit tjetër mjekësor, në mënyrë që t'u pritët rruga korrupsionit dhe qëndrimeve kundër etikës profesionale; të ngrihet në nivelin që i takon dinjiteti i mjekut; ristrukturimi dhe efektiviteti i sistemit të sigurimeve shëndetësore.

Sistemi i ri i sigurimeve shëndetësore do të synojë krijimin e kushteve për të mos lejuar qëndrime shpërdoruese nga ana e punëdhënësve, të cilët, në shumë raste, nuk u paguajnë detyrimet e sigurimit punëtorëve, duke i lënë ata jashtë përfitimit të trajtimit shëndetësor falas. Njëkohësisht, do të stimulohet zhvillimi i aktiviteteve mjekësore private, por në kushte ligjore rreptësisht të përcaktuara, të përshtatshme dhe të denja.

26. Konsolidimi i familjes

Pozicioni i Partisë Shpresa Demokrate, lidhur me familjen, është i qartë dhe i papajtueshëm me cilindo qëndrim, që synon dobësimin e këtij institucioni jetik për një shoqëri të zhvilluar dhe për një komb të denjë e të përparuar. Politikën, lidhur me familjen, do të synojnë forcimin e konsolidimit të saj, duke e ruajtur nga dukuritë shoqërore negative, që synojnë dobësimin dhe transformimin e saj. Për Partinë tonë familja është rinia e kombit, vazhdimësia e kombit, forca e kombit, përparimi i kombit, dinjiteti i kombit, thelbi i shenjtë i ekzistencës së kombit.

27. Partia Shpresa Demokrate garanton të drejtat e grave.

Në politikën e saj Partia jonë do të jetë e qartë dhe e vendosur për të siguruar barazinë e burrit me gruan në të gjitha aspektet e jetës. Gruaja konsiderohet si forcë thelbësore dhe shumë e rëndësishme për një shoqëri të emancipuar demokrate. Gruaja e meriton krijimin e të gjitha shanseve të barabarta me burrin, për të thënë fjalën e saj në politikë, në zhvillimin e ekonomisë, në ruajtjen e moralit e në garantimin e trashëgimisë kulturore të kombit.

28. Partia Shpresa Demokrate garanton mbrojtjen e interesave të fëmijëve.

Lidhur me fëmijët dhe të rinjtë, do të synohet përgatitja e kuadrit ligjor e institucional për mbrojtjen e veçantë të tyre si

dhe për krijimin e kushteve për rritje dhe edukim me ndjenja të pastra kombëtare dhe norma morale. Do të punohet për krijimin e një sistemi të përshtatshëm të edukimit parashkollor, shkollor e universitar, si dhe për hartimin e programeve didaktike, të cilat stimulojnë zhvillimin intelektual të tyre, si dhe rrënjosin e konsolidojnë nderim, respekt e krenari për kombin. Duke pasur parasysh se kjo kategori e shoqërisë është e ardhmja e kombit,do të synohet krijimi i kushteve të përshtatshme për kalimin e kohës së lirë, por në të njëjtën kohë edhe për edukimin me normamorale dhe ndjenja atdhetare. Të rinjve do t'u njihet e drejta që të përfitojnë pagesë mujore gjatë kohës që do të kryejnë shërbimin ushtarak dhe mbas shërbimit do të kenë përparësi të tjera.

29. Partia Shpresa Demokrate garanton pensionistët.

Një shtresë ndaj se cilës Partia Shpresa Demokrate do të tregojë kujdes e interesim të veçantë janë pensionistët. Është e qartë se ata janë shtresa më e varfër e popullsisë. Në një kohë kur, për dhjetëra vite, kanë derdhur djersë dhe mund, duke punuar vetëm për bukën e gojës, sot marrin si shpërblim pensione qesharake,që nuk u mjaftojnë as për të

paguar furnizimin me ujë dhe energji elektrike. Për këtë shtresë të popullsisë Partia jonë siguron se do të jepen pensione të përshtatshme, duke pasur si kufi minimal vlerën prej 600 euro , e cila do të indeksohet çdo vit sipas ritmeve të inflacionit. Ne garantojmë që sistemin e pensioneve ta njësojmësi për pensionistët në qytet edhe në fshat. Qëndrimi ynë është kundër dallimeve të tilla, pasi të dyja këto grupe pensionistësh kanë punuar dhe janë shfrytëzuar njëllor dhe nevojat i kanë të së njëjtës natyrë.

30. Partia Shpresa Demokrate u garanton punonjësve të arsimit rritje të pagës.

a. Politikat e Partisë sonë do të përfshijnë një reformim të plotë të sistemit arsimor në drejtim të riorganizimit e të ristrukturimit, përtë ngritur atë në nivele bashkëkohore dhe për të tërhequr një numër sa më të madh studentësh në shkollat e larta. Përveç krijimit të sistemit parashkollor, do të parashikohet edhe ngritja e shkollave të reja dhe pajisja e tyre me të gjitha mjetet e nevojshme mësimore dhe me mjedise e shërbime të domosdoshme për edukimin e fëmijëve e të rinjve. Në programet mësimore dhe në veprimtaritë edukative, një vend të rëndësishëm do të zërë edukimi i brezit të ri me ndjenja kombëtare. Në funksion të një sistemi arsimor të përparuar, do të vendosen kritere të rrepta dhe do të prashikohen procedura të qarta për punësimin e personelit pedagogjik dhe ngritjen e tij profesionale.

b. Në politikat e Partisë sonë vëmendje e veçantë do t'i kushtohet rritjes së pagës të mësuesve e të pedagogëve, në mënyrë që puna e tyre të shpërblehet plotësisht dhe të respektohet plotësisht dinjiteti i tyre. Programet tona parashikojnë pagesa sipas nivelit të ngarkesës dhe vlerës së diplomës. Konkretisht, parashikojmë pagesën minimale mujore të mësuesve të shkollave fillore e 8-vjeçare prej

1,000 euro; për mësuesit e shkollave të mesme paga minimale mujore të jetë 1,000; për pedagogët e universiteteve paga minimale mujore të jetë 2,000 euro, duke u shtuar për të gjithë ata, që kanë grada shkencore, sipas gradës.

31. Kultura dhe Arti

a. Në fushën e kulturës do të ndiqet politika e mbledhjes, e restaurimit dhe e paraqitjes, brenda e jashtë vendit, e vlerave kulturore të kombit tonë. Do të nxitet ruajtja e monumenteve të kulturës dhe do të organizohen veprimtari, në të cilat do të nxirret në pah roli historik, politik e kulturor i kombit tonë dhe vendi që itakon atij si populli më i lashtë i Ballkanit.

b. Politika stimuluese do të ndiqen edhe për zhvillimin e arteve të bukura e sidomos për krijimin e konsolidimin e një brezi tëri artistësh të talentuar, por gjithmonë pa lënë në harresë vlerat e deritanishme, folklorin dhe artin bashkëkohor, për çka do të ndiqen edhe praktika të financimit nga shteti.

32. Partia Shpresa Demokrate tregon një kujdes të veçantë për forcat e armatosura ushtarake.

Nevoja e ristrukturimit të forcave të armatosura ushtarake dhe pajisja e tyre me armatim e teknikë bashkëkohore, konsiderohetsi e menjëhershme dhe e vazhdueshme. Në këto kushte do të synohet ngritja e përgatitja e strukturave ushtarake, të pajisura mirë e të afta për t'i bërë ballë çdo situatë, që paraqet rrezik për kombin. Bashkëpunimet ushtarake do të zhvillohen mbi bazën e reciprocitetit dhe të respektimit të integritetit shtetëror e dinjitetit kombëtar, duke synuar përgatitjen dhe specializimin e ushtarakëve kosovarë në vendet e zhvilluara. Gjithashtu, do të rishikohet sistemi i pagesës dhe i pensioneve për ushtarakët, me synimin për t'i rritur, duke u siguruar atyre të ardhura të mjaftueshme për të jetuar normalisht, me dinjitet e pa u korrumpuar. Brenda këtyre programeve do të garantohet për ushtarakët edhe strehimi falas e me përparësi, në përputhje me normat bashkëkohore të strehimit.

33. Partia Shpresa Demokrate u garanton punonjësve të policisë rritjen maksimale të pagës.

a. Duke e konsideruar një problem me rëndësi jetike për zhvillimin e vendit çështjen e rendit dhe të qetësisë, do të ndërmerren të gjitha nismat për të krijuar kushte lidhur me zhvillimin e një lufte efektive kundër kriminalitetit, në të gjitha format, në të cilat shfaqet ai. Dotë riorganizohen strukturat

policore për të rritur profesionalizmin, pastërtinë, devotshmërinë dhe efektivitetin e punës së tyre. Kritere të rrepta e profesionale do të caktohen në përzgjedhjene punonjësve të policisë. Do të synohet pastrimi i strukturave policore nga elementët e inkriminuar dhe do të merren masa të ashpra ndaj të gjithë elementëve të korruptuar në radhët e saj. Nëpërmjet shkollimit e specializimit, do të synohet përgatitja dhe edukimi i punonjësve të policisë me dije

shkencore bashkëkohore, me norma të shëndosha morale, me edukatë qytetare, me ndjenjën e respektit për shtetin e kombin dhe me ndjenjën e përgjegjësisë etë shenjtërisë së detyrës, që kryejnë; për t'u kthyer punonjësve të policisë dinjitetin e nevojshëm si dhe për të rritur përkushtimin e tyre në kryerjen e detyrës me ndershmëri e profesionalizëm.

b. Partia jonë dhe e juaja do të rishikojë sistemin e pagave të tyre, duke garantuar se paga minimale në dy javë do të jetë 950 euro, pagë e cila, sipas shkallës së vështirësive, do të rritet derinë kufirin e 1,200 euro. Për punonjësit e policisë dhe për familjet e tyre do të parashikohet një sistem i veçantë sigurie, në rastet kur kërcënohet integriteti i tyre fizik. Gjithashtu, do të parashikohen pensione të posaçme si dhe do të garantohet strehimii tyre.

34. Partia Shpresa Demokrate garanton reformimin, organizimin, ngritjen e nivelit profesional dhe pavarësinë e plotë të pushtetit gjyqësor.

a. Si shtylla kryesore dhe instanca e fundit e kontrollit të veprimtarisë së pushteteve të tjera, pushteti gjyqësor konsiderohet si pika më delikate e një shteti. Për këtë arsye, një vend të rëndësishëm dotë zënë, në politikat e Partisë, reformimi i organizimit të pushtetit gjyqësor dhe ngritja e nivelit të profesionalizmit e të pavarësisë së tij. Organizimin e pushtetit gjyqësor e konceptojmë si një trupë të pushtetshme, e cila përbëhet nga individët më të pastër nga pikëpamja morale, më të paanshëm nga pikëpamja e ndërgjegjes, më të ngritur nga pikëpamja profesionale, më të moderuar nga pikëpamja shoqërore, më të respektuar nga strukturat dhe organet shtetërore dhe më të trajtuar nga pikëpamja financiare. Vetëm persona të tillë, gjyqtarë apo prokurorë, mund të jenë luftëtarët denjë e të paepur kundër fenomenit të korrupsionit dhe të kriminalitetit të organizuar apo ordiner. Vetëm persona me cilësitë e mësipërme mund të na krijojnë besimin se do të bëjnë detyrën e nderuar e të shenjtë të dhënies së drejtësisë.

b. Partia Shpresa Demokrate do të synojë edhe në krijimin e një sistemi gjyqësor, i cili të jetë i kontrollueshëm nga vetë strukturat e tij dhe të sigurojë mbrojtjen e të drejtave themelore të individit. Kontrolli i vendimeve të një gjykate është konceptuar të bëhet nga një gjykatë më e lartë, duke siguruar, në çdo rast, të drejtën e individit për t'u ankuar ndaj vendimit të një gjykate në një gjykatë më të lartë.

c. Në themel të veprimtarisë së gjyqësorit do të jetë parimi i shenjtë i ligjshmërisë, çka nënkupton se gjyqtari është i varur vetëm nga ligji. Qëndrimi ynë është i qartë lidhur me këtë parim dhe do të punojmë që të respektohet ai rreptësisht, që gjykata, qoftë edhe në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, të mos ketë attribute ligjbërëse, të cilat i takojnë legjislativit, si organi përfaqësues i sovranit popull. Qëndrimi ynë është i qartë edhe për sa i përket zgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë duhet të jenë të përjetshëm, me qëllim që mandatet e tyre të mos jenë objekt lakmie, egoizmi e kompromisesh politikë.

d. Lidhur me sistemin gjyqësor, qëndrimi ynë është se duhet të ketë tri nivele gjykatash, të cilat të kenë në krye Gjykatën e Lartë, që do të ketë edhe kompetencat e kontrollit të kushtetutshmërisë së akteve të organeve të tjera.

Për t'i siguruar pushtetit gjyqësor pavarësinë e nevojshme, nedo të ndërmarim të gjitha nismat e nevojshme, për të krijuar kështu kuadrin ligjor, i cili të parashikojë krijimin brenda këtij pushteti të një organi vendimmarrës jopolitik, për emërimet, ngritjen në detyrë dhe procedimin disiplinor të gjyqtarëve e të prokurorëve. Në funksion të konsolidimit të këtij pushteti dotë kryhen edhe investime për krijimin e kushteve të nevojshme lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së dhënies së drejtësisë në mënyrë solemne e të denjë, duke u dhënë gjykatave atë paraqitje, që duhet të kenë "faltoret e shenjta të drejtësisë". Jashtë objektit tëpolitikave të Partisë Shpresa Demokrate nuk do të jetë as trajtimi financiar, si dhe mbrojtja fizike e sigurimi i kushteve normale e tëdenja për jetesën e gjyqtarëve dhe të prokurorëve.

35. Partia Shpresa Demokrate garanton funksionimin e pushtetit ekzekutiv. Një rëndësi e veçantë do t'i kushtohet krijimit të strukturave efektive dhe fleksibël, për të bërë të mundur zbatimin e drejtë të legjislacionit në fuqi.

a. Lidhur me organizimin e strukturave administrative të këtij pushteti, Partia Shpresa Demokrate ka si objektiv përgatitjen e një kuadri ligjor të qartë, i cili do të përcaktojë kriteret e rrepta lidhur me rekrutimin e nëpunësve, por në të njëjtën kohë do të respektohet e do të mbrohet me ligj cilido nëpunës, që në punën e tij tregon nivel profesional, respektim

të ligjit e vlera morale. Ne garantojmë krijimin e një klime të përshtatshme ligjore, që do t'ukthejë sigurinë dhe dinjitetin e nëpunësve të ndershëm, të cilët deri tani janë trajtuar pa respekt nga eprorët e tyre të korruptuar, sa herë që janë përpjekur të zbatojnë ligjin.

b. Një përparësi e veçantë do të jetë krijimi i strukturave efektive, në të cilat do t'i gjendet punës njeriu dhe jo njeriut punë. Numri i nëpunësve në administratën shtetërore do të përcaktohet nga nevojat reale, që paraqiten gjatë funksionimit të saj dhe jo nga qëndrimet subjektive të organeve vendimmarrëse. Nuk do të lejohet krijimi i strukturave joefektive për të kënaqur tarafet, nepotizmin apo egoizmin paradoksal e të pangopur të pseudopolitikanëve

antishqiptarë, që nuk mendojnë se shpenzimet e tyre të pajustificuara janë shpenzime, të cilat përballohen nga taksat, pra nga populli.

c. Po në të njëjtën kohë lejon organizimin e një lufte rezultative kundër fenomenit të korrupsionit dhe të inkriminimit të zyrtarëveshtetërorë, fenomen ky që çon në mënyrë të pashmangshme në shkatërrimin e shtetit.

Një përparësi të veçantë do të ketë përzgjedhja dhe kualifikimi i nëpunësve, duke pasur si kriter bazë profesionalizmin. Për rritjen e nivelit të efektshmërisë së administratës shtetërore do të ndiqen politika, të cilat do të mundësojnë rekrutimin e nëpunësve të rinj në moshë dhe të aftë për të mësuar e për t'u specializuar, në mënyrë që në veprimtarinë e tyre të praktikojnë dije të nivelit bashkëkohor. Pjesë e rëndësishme e këtyre politika ve do të jetë edhe rishikimi e përmirësimi i trajtimit financiar, si stimul bazë për kryerjen e detyrës profesionalisht.

36. Partia Shpresa Demokrate garanton organizimin dhe funksionimin e shtetit demokrat.

Të vetëdijshëm për rëndësinë që ka ndërtimi i shtetit ligjor, me qëllim realizimin e programit në funksion të progresit kombëtar, duke mbajtur parasysh dëmet e mëdha, që u janë shkaktuar ndërgjegjes kombëtare dhe dinjitetit të Republikës së Kosovës në komunitetin ndërkombëtar, prapambetjen ekonomike dhe anarkinë politike, rrjedhojë e qëndrimeve të papërgjegjshme të antishqiptarëve të pas Luftës së II Botërore, një nga synimet kryesore të Partisë Shpresa

Demokrate është krijimi i shtetit ligjor, i bazuar në parimet demokratike dhe në ndarjen e balancimit të pushteteve.

b. Partia jonë garanton të drejtën e popullit të Republikës së Kosovës për t'u shprehur dhe për të vendosur lirisht e drejtëpërdrejt për formëne organizimit politik shtetëror, që dëshiron të ketë. Garanton se cilido që të jetë verdikti i popullit, do të respektohet plotësisht. Sithelbin e konceptit të shtetit ligjor ne konsiderojmë organizimin e organeve dhe të strukturave administrative, të cilat në veprimtarinë e tyre të karakterizohen nga racionalizmi, profesionalizmi, transparenca publike, respektimi i ligjit, kontrolli i brendshëm dhe i jashtëm.

Si qëllim bazë i ngritjes dhe i funksionimit të strukturave shtetërore do të konsiderohet ndërtimi i një shteti në funksion të interesave të shtetasve. Qëndrimi ynë i vazhdueshëm do të jetë lufta kundër shmangies së strukturave shtetërore nga detyrat ligjore, kundër degjenerimit të shtetit në një shtet-qëllim në vetvete dhe kthimine tij në vegël në funksion të njerëzve të korruptuar, me qëndrime e veprimtari kriminale e antishqiptare, papajtueshmërisht me fenomenin e korrupsionit të çdo niveli.

d. Partia Shpresa Demokrate garanton përgatitjen e kuadrit ligjor dhe të strukturave efektive për penalizimin dhe luftën deri në mposhtjen përfundimtare të këtij fenomeni, i cili ka vënë në rrezik ekzistencën e kombit. Do të merren masa për të mos lejuar punësimin në strukturat shtetërore të personave, të cilët gjatë jetës së tyre, qoftë edhe një herë,

janë dënuar për korrupsion, pavarësisht se masa e lloji i dënimit mund të kenë qenë të lehta. Shteti do t'u sekuestrojë e do t'u konfiskojë personave të dënuar për korrupsion, çdo gjë që ata kanë përfituar nga korrupsioni.

37. Partia Shpresa Demokrate u garanton fshatarëve dhënien e kredive për blerjen e makinerive bujqësore, për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe sigurimin e mirëqenies familjare.

a. Lidhur me zhvillimin e bujqësisë dhe të blegtorisë, do të ndiqen politika e programe të përshtashme, të cilat do të kenë si përparësi dhënien e tokës fshatarëve, që duan ta punojnë atë, dhënien e kredive me kushte lehtësuese për blerjen e farërave, plehrave kimike, pesticideve dhe të mjeteve e pajisjeve bujqësoretë nevojshme. Gjithashtu, do të ndiqen politika të veçanta përtë garantuar prodhimin bujqësor vendas nga konkurrenca e prodhimit bujqësor të huaj, duke parashikuar detyrime doganore të karakterit mbrojtës për importet e prodhimeve bujqësore të huaja e duke siguruar kështu zhvillimin e një bujqësie bashkëkohore e intensive.

b. Jashtë politikave tona nuk do të mbetet edhe hartimi i programe ve të qarta, që do të synojnë përgatitjen e kuadrit, me nivelin profesional të nevojshëm, për zhvillimin e bujqësisë dhe të blegtorisë. Do të synohet të ngrihen struktura të posaçme për grumbullimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale nga prodhuesii vogël, që të mos shpenzohet kohë e energji me tregtimin e prodhimit nga çdo prodhues.

38. Partia Shpresa Demokrate garanton nxitjen e investimevetë huaja. Po ashtu dhe aktiviteti i kompanive të huaja private do të kontrollohet nga shteti.

Në fushën e investimeve garantohet përgatitja e kuadrit ligjor të nevojshëm, në mënyrë që të nxitet investimi i kapitalit të huaj, sidomos në sektorët me rëndësi strategjike për zhvillimin e vendit. Për këtë do të synohet krijimi i lehtësive fiskale për investitorëte huaj dhe do t'u ofrohen atyre sektorë të tillë të rëndësishëmsi: kërkim-shfrytëzimi i mineraleve, nxjerrja e përpunimi i naftës, telekomunikacionet, të cilat bëjnë të mundur zhvillimin e prodhimit tonë dhe hapjen e vendeve të punës.

39. Partia Shpresa Demokrate garanton të rishikohet sistemi fiskal.

Lidhur me zhvillimin e ekonomisë së vendit, Partia Shpresa Demokrate do t'u japë përparësi disa çështjeve kryesore. Konkretisht, do të rishikohet sistemi fiskal, duke u vendosur taksa, të cilat do të bazohen në kritere të studiuara e të qarta, në mënyrë që barra tatimore të mos pengojë rritjen e nivelit të kushteve të jetesës së popullsisë, të stimulojë shtimin e numrit dhe zhvillimin e biznesit të vogël e të mesëm dhe të shmangë krijimin e monopoleve në aktivitetet tregtare. Do të ndiqet politika e vendosjes së tatimeve me karakter mbrojtës, për të nxitur prodhimin vendas dhe për t'i prerë rrugën konkurrencës së mallrave të huaja si dhe daljes së valutës jashtë vendit. Sistemi bankar do të stimulohet e do të nxitet

për t'u bërë efektiv në zhvillimin e ekonomisë vendase dhe bashkëkohore, nga pikëpamja e funksionimit dhe e ofrimit të shërbimeve ndaj individit.

40. Partia Shpresa Demokrate do të vërë theksin në decentralizimin e pushtetit vendor.

a. Duke marrë në konsideratë burimet natyrore të vendit tonë, të cilat, si për nga lloji edhe për nga shtrirja gjeografike, e bëjnë vendin tonë një nga më të pasurit, në raport me numrin e popullsisë, si dhe përvojën e vendeve të zhvilluara të demokracive përëndimore, në organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor, do të rikonceptohet kuadri ligjor i organizimit dhe i funksionimit të qeverisjes vendore. Objekt i këtij riorganizimi do të jetë përcaktimi i qartë i strukturave qeverisëse demokratike, veprimtaria e të cilave do të jetë një shprehje dhe pjesëmarrje më e madhe e vullnetit të zgjedhësve të njësisë administrative për zgjidhjen e problemeve të tyre. Me këtë kuadër ligjor do të rregullohet e drejta e strukturave të qeverisjes vendore, për të pasur në administrim të drejtpërdrejtë e të plotë, në interes të banorëve të njësisë përkatëse, pasuritë natyrore shtetërore, që ndodhen brenda territorit, ku shtrihet juridiksioni i kësaj strukture.

b. Duke iu referuar pozicionit gjeografik dhe mundësive reale, që ofron natyra jonë, do të synohet zhvillimi i turizmit nga banorët e zonave turistike, duke mos lejuar në asnjë rast përdorimin e zonave turistike si objekt për të pasuruar pushtetarët. Zonat turistike do të jenë një pasuri, e cila u takon pronarëve të ligjshëm dhe do të administrohet vetëm nga ata.

Këto zona nuk mund të jenë objekt interesash politike apo interesash të ngushta personale.

c. Marrëdhëniet e pushtetit qendror me organet e pushtetit vendordo të sanksionohen si marrëdhënie partnerësh të barabartë dhe jo si marrëdhënie epror-vartës. Këto marrëdhënie do të kenë për objekt dhënien e ndihmave materiale dhe kreditimin e ekonomisë, si dhe përmirësimin e mënyrës së organizimit e të funksionimit të organeve të pushtetit vendor, në funksion të realizimit të interesave ekonomike, morale e politike të banorëve të njësisë vendore përkatëse.

41. Partia Shpresa Demokrate garanton që populli i Republikës së Kosovës të arrijë një nivel ekonomik të barabartë me popujt e Evropës dhe t'i japë kredi financiare çdo shtetasi kosovar.

Me besimin e patundur në drejtësinë e qëllimit dhe të rrugës sonë si dhe me besimin te Zoti, do të punojmë e do të luftojmë me të gjitha forcat për realizimin e këtij programi, për përmbushjen e amanetit të të parëve tanë, për realizimin e interesave dhe të aspiratave të kombit, për progresin dhe dinjitetin moral të çdo shqiptari, për ta bërë vendin tonë një vend demokrat të mirëfilltë, të përparuar e të nderuar në të gjithë Botën.

Kryetari i Partisë Shpresa Demokrate

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Z. Bylbyl Miftari', is written above a solid horizontal line. The signature is fluid and cursive.

z.Bylbyl Miftari

Ndalohet riprodhimi, në çdo lloj mënyre, i programit ose i pjesëve të tij, pa lejen e autorit. E drejta e autorit është e rezervuar dhe mbrohet sipas legjisllacionit në fuqi.